

**KOMISIONI I PËRBASHKËT I SHQIPËRISË DHE KOSOVËS PËR MIRATIMIN E
TEKSTEVE MËSIMORE PËR DIASPORËN**

VENDIM

Nr 3, datë 05.08. 2020

Për

**MIRATIMIN E “KALENDARIT TË RI TË PUNËS 2020-2021 SË KOMISIONIT TË
PËRBASHKËT TË SHQIPËRISË DHE KOSOVËS PËR MIRATIMIN E TEKSTEVE
MËSIMORE PËR DIASPORËN”**

Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe Kosovës për miratimin e teksteve mësimore për diasporën, i krijuar në zbatim të Marrëveshjes së bashkëpunimit datë 23.03.2015, e lidhur në Tiranë, ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Diasporës të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës “Për organizimin e përbashkët të mësimit të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë”, Vendimit nr. 2-1151, datë 7.07.2020, “Për emërimin e grupit të punës”, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Kosovës, si dhe Urdhrit nr. 6, datë 22.07.2020, “Për Koordinimin nga Qendra e Botimeve për diasporën të veprimtarisë së Komisionit të Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për miratimin e teksteve mësimore për Diasporën”, pasi diskutoi sipas rendit të ditës,

V E N D O S I:

1. Miratimin e “Kalendarit të ri të punës 2020-2021 së Komisionit të Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën”, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Qendra e Botimeve për Diasporën të marrë masa për zbatimin e këtij kalendarit pune.

KOMISIONI I PËRBASHKËT

Kryetare: Anila Ferizaj

Zëvendëskryetare: Shqipe Gashi-Ramadani

Z. Arbër Salihi

Z. Ymer Avdiu

Znj. Erida Koleci

Z. Edmond Ahmeti

Anëtarët:

Z. Isni Kryeziu

Znj. Feime Llapashtica

Znj. Evis Mastori

Znj. Mimoza Hysa Çuliqi

**KALENDARI I PUNËS SË KOMISIONIT
TË PËRBASHKËT SHQIPËRI – KOSOVË PËR MIRATIMIN
E TEKSTEVE MËSIMORE PËR DIASPORËN**

Nr.	Veprimtaritë	Afati
1.	Rishikimi i standardeve të teksteve mësimore të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare për mësimin plotësues në diasporë dhe në mërgatë.	Gusht 2020
2.	Konsultim me mësues në diasporë të standardeve të teksteve mësimore të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare për mësimin plotësues në diasporë dhe në mërgatë.	Gusht 2020
3.	Miratimi i standardeve të teksteve mësimore të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare për mësimin plotësues në diasporë dhe në mërgatë.	Shtator 2020
4.	Hartimi i dokumentit për procedurat e konkurrimit dhe vlerësimit të teksteve të përbashkëta mësimore të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare për mësimin plotësues në diasporë dhe në mërgatë.	Shtator – Tetor 2020
5.	Publikimi i dokumentit për procedurat e konkurrimit dhe vlerësimit të teksteve të përbashkëta mësimore të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare për mësimin plotësues në diasporë dhe në mërgatë nga ministritë përgjegjëse të Arsimit të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës.	Tetor 2020
6.	Miratimi i listës së recensentëve të teksteve të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare për Diasporën.	Nëntor 2020
7.	Përgatitja dhe publikimi i videove informuese për recensentët e teksteve të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare për Diasporën për procedurat e vlerësimit, duke u bazuar te: - Standardet e teksteve të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare për Diasporën. - Kurrikula e mësimin plotësues të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në Diasporë dhe në mërgatë.	Nëntor 2020
8.	Mbyllja e procesit të vlerësimit të teksteve mësimore të përbashkëta të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare për mësimin plotësues në diasporë dhe në mërgatë.	Qershor 2021

